

TERMAT E REFERENCES

**PËR HARTIMIN E PDV-VE FAZA I & II
PËR REALIZIMIN E PYLLIT ORBITAL TË TIRANËS**




TABELA E PËRMBJATJES

HYRJE.....	3
ORGANIZIMI I KONKURSIT.....	4
Promovues.....	4
Këshillues profesional dhe teknik.....	4
Sekretariati i konkursit.....	4
QËLLIMI I KONKURSIT.....	4
PËRSHKRIMI I ZONËS- KUFIJTË E SHTRIRJES.....	5
ZONA E KONKURSIT.....	6
Metodologjia për realizimin e Pyllit Orbital.....	6
Buxheti i projektit.....	6
PROCEDURAT DHE PROGRAMI I KONKURSIT.....	7
MENYRA E PJESËMARRJES DHE FAZAT E KONKURSIT.....	7
KALENDARI I KONKURIST.....	9
Anekse:.....	10



Në 15 vitet e fundit, qyteti i Tiranës ka pësuar një rritje të fortë demografike. Për të përballuar një kërkesë të lartë për banesa, qyteti i ndërtuar është zgjeruar në këtë mënyrë në drejtim të pakontrolluar jo vetëm në zonat e qytetëruara por edhe në zonat ish bujqësore dhe natyrore. Plani i Përgjithshëm Vendor ka për qëllim të luftojë këtë fenomen, të kufizojë konsumin e tokës, të ruajë zonat bujqësore dhe natyrore duke parashikuar ku të jetë e nevojshme rinatyrizimin e tyre. PPV TR030 propozon krijimin e Pyllit Orbital si një kufi hije-bërës të zonës urbane, si një kufi natyral ndaj rritjes urbane që lidh parqet ekzistuese periurbane, zonat bujqësore, zonat pyjore, zonat rreth liqeneve.

Kufijtë e tij prekin zonën në perëndim të aksit tregtar Tiranë Durrës dhe zonën me densitet të lartë, Kasharin, në jug të Selitës, dhe Sauk 1, në lindje të Parkut të Liqenit të Farkës dhe të Parkut Kombëtar të Dajtit si dhe në veri të Lumit Tirana.

Bazuar në *ligjin 107/2014 "Për Planifikimin e Territorit"* (i ndryshuar) dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, është hartuar Plani i Përgjithshëm Vendor për territorin e ri administrativ të Bashkisë Tiranë. Gjatë hartimit të këtij plani janë identifikuar dhe përkufizuar ligjërisht dhe teknikisht nëpërmjet mënyrave të ndërhyrjes në territor si dhe kushteve të zhvillimit, limitet maksimale të shtrirjes së sistemit urban në mjedisin natyror dhe bujqësor, të identifikuar nga kuadri ligjor në fuqi si vija e gjelbër e qytetit. Gjatë hartimit të strategjisë territoriale ky përkufizim ligjor është transformuar në një projekt strategjik shumë dimensional që prek kryeqytetin duke ndikuar në aspektet juridike, mjedisore dhe arkitektonike. Për sa më sipër, për njësinë administrative të Tiranës, ky projekt strategjik përkufizon Pyllin Orbital (Metrobosco) të kryeqytetit.

Në këtë kuptim, Pylli Orbital, përcaktohet si një instrument për frenimin e konsumit të tokës (bujqësore dhe natyrore), shpërhapjes urbane e identifikuar si kufiri fizik i zhvillimit dhe zgjerimit të sistemit urban në mjedisin natyror. Ky kufi përkufizohet në terma ligjore dhe teknike si një brez me funksion natyralizimi, që do të lidhë parqet ekzistuese suburbane, zonat bujqësore, zonat pyjore dhe zonat përreth liqeneve, duke qenë kështu në vetvehte një nga hapësirat e reja të gjelbërta të Tiranës. Me një sipërfaqe prej 2563.8 ha ky pyll konceptohet si një brez mbrojtës i cili do të ketë mundësi të bllokojë konsumin e tokës duke krijuar një unazë me pemë frutore, parqe, pyje me natyralizim të gjeneruar nga një brez përkufizues të kryeqytetit prej rreth 2 milionë pemësh.

ORGANIZIMI I KONKURSIT

Promovues

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Agjencisë Italiane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, Selia Tiranë dhe Bashkia Tiranë për të mbështetur ndërtimin e një brezi të gjelbër publik urban, Pyllin Orbital të Tiranës, që synon të rrethojë zonën urbane ekzistuese të qytetit, jepet kontributi financiar për analizën dhe hartimin e 23 Planeve të Detajuara Vendore (Faza I dhe Faza II) të identifikuara nga Bashkia e Tiranës që përcaktojnë realizimin e këtij pylli.

Këshillues profesional dhe teknik

Për koordinimin, realizimin dhe vlerësimin e procesit të këtij konkursi është ngarkuar Grupi i Punës i ngritur me urdhër të kryetarit


Sekretariati i konkursit

Vlerësimi i dokumentacionit teknik do të kryhet nga Këshilli Teknik i Bashkisë së Tiranës, i ngritur me urdhrin, nr.11987, dt.20.04.2016 të Kryetarit të Bashkisë *“Për ngritjen e Këshillit Teknik të Bashkisë së Tiranës” (i ndryshuar).*

QËLLIMI I KONKURSIT

Pylli Orbital i Tiranës përbëhet prej 269 njësi strukturore prej të cilave 23 janë përcaktuar si njësi subjekt PDV, me një sipërfaqe totale prej 425 ha.

Qëllimi kryesor i këtij konkursi është hartimi i PDV faza I dhe PDV Faza II e 23 njësive strukturore për realizimin e Pyllit Orbital të Tiranës.



PËRSHKRIMI I ZONËS- KUFIJTË E SHTRIRJES

Pylli Orbital ka një sipërfaqe prej 2563.8 ha dhe lidh 5 mjedise të ndryshme, të paraqitura në hartën e shtrirjes së Pyllit Orbital dhe parqet përbërëse, shtojca 1:

Parku Kombëtar i Dajtit

Parku Kombëtar i Dajtit konsiderohet zonë e mbrojtur dhe është i përbërë kryesisht nga pyje dhe nga disa zona ku ndodhen rezervuare me ujë, të cilat shërbejnë kryesisht për aktivitete bujqësore familjare. Ky park përfshin habitatin e përkryer për aktivitete që lidhen me turizmin e qëndrueshëm si ecjet dhe ngjitjet në mal.

Oazet Natyrore – Parku Rekreativ i Farkës

Zona që rrethon Liqenin e Farkës është pika ku brezi i gjelbër depërton në qytet duke ndërlidhur parkun me unazën e katërt dhe mjedisin urban të pjesës jug-lindore të kryeqytetit.

Për karakterin e tij natyror, afërsinë me Parkun Kombëtar të Dajtit dhe për shkak të mungesës së problemeve të mëdha të ndotjes apo pikave të përqendrimit, kjo zonë mund të konsiderohet si një rezervë natyrore, një zonë e mbrojtur për specie të egra dhe aktivitete rekreative.

Pyjet frutore produktive

Zona ndërmjet ish komunës së Vaqarrit dhe Farkës përbën lidhjen natyrore ndërmjet Parkut të Lumit Erzen dhe Parkut të Liqenit. Karakterizohet nga fusha kodrinore të cilat në të kaluarën janë përdorur për shfrytëzimin e aktiviteteve bujqësore, e ndikuar negativisht nga prania e landfillit të Sharrës që kërkon vepra të rëndësishme të mitigimit mjedisor.

Zonat bujqësore

Kjo zonë, e kufizuar nga aksi Tiranë-Durrë SH2/SH56, është pjesë e një territori të madh bujqësor të përbërë kryesisht nga pyje dru-frutorësh të cilat ndonëse ndikojnë në gjenerimin e siluetës së gjelbër të Tiranës mundësojnë gjenerimin e ekonomisë bujqësore në këto territore.

Kjo zonë shtrihet në Parkun e Liqenit Allgjatë, Parkun e Liqenit të Kasharit deri në pjesën veri-lindore të njësisë administrative Vaqarr.

Parku i Lumit të Tiranës

Parku i Lumit të Tiranës përbëhet nga hapësira më e re e gjelbër e pjesës veriore të Tiranës, pjesë e sistemit natyror të brigjeve të lumit. Përgjatë kësaj hapësire përfshihen sipërfaqet rekreative dhe natyrore të cilat jo vetëm do të markojnë si siluete pejsazhi vijën ujore të lumit të Tiranës por edhe do të mundësojnë gjenerimin e aktiviteteve rekreative për pjesën veriore të qytetit.

ZONA E KONKURSIT

Territori i cili nënshtrohet realizimit të pyllit orbital sipas përcaktimeve të TOR, ndahet në 3 LOT-e,

sipas përcaktimeve grafike dhe përmbajtësore në hartën dhe shtojcën 2.

LOT 1 shtrihet në zonën bujqësore të Kasharit dhe Pyjet Produktive (plotëso).

Përbëhet nga 5 njësi strukturore:

KA/54, FA/114, TR/212, TR/209, FA/24

LOT 2 shtrihet në zonën e Pyjeve produktive dhe oazeve natyrore (plotëso)

Përbëhet nga 9 njësi strukturore

TR/66, TR/67, TR/68, TR/70, FA/2, FA/54, FA/58, FA/87, FA/139

LOT 3 shtrihet në zonën e Oazeve Natyrore dhe Parkut të Dajtit.

Përbëhet nga 9 njësi strukturore subjekt PDV:

TR/72, TR/143, TR/144, TR/148, TR/149, TR/151, TR/152, TR/455, TR/508, DA/52

Metodologjia për realizimin e Pyllit Orbital

Planet e Detajuara Vendore të identifikuara që prekin kufirin e Pyllit Orbital të Tiranës, kanë detyrimin të përcaktojnë kushtet për realizimin e këtij pylli duke stimuluar Partneritetet Publike - Private për uljen e kostove dhe realizueshmërinë e tij duke respektuar procedurat tekniko – ligjore sipas kushteve të përcaktuara në ligjin nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar); VKM Nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”; VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 “për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”; VKM Nr.1, datë 14.04.2017 “Rregullore e Planit të Përgjithshëm Vendor” dhe “Rregullat dhe kushtet për realizimin e Pyllit Orbital të Tiranës” miratuar me urdhër të Kryetarit të Bashkisë dt.29.12.2017.

Analiza dhe Hartimi i PDV duhet të mbështetet në Strukturën për hartimin e PDV – Faza I dhe Faza II, sipas anexit X (STRUKTURA PER HARTIMIN E PDV-se Faza I dhe Faza II)

PROCEDURAT DHE PROGRAMI I KONKURSIT

MENYRA E PJESËMARRJES DHE FAZAT E KONKURSIT

LLOJI I KONKURSIT: Konkurs me 7 faza

FAZA 1 THIRRJE E HAPUR PËR PJESMARRJEN NË KONKURS

Kërkesat	<p>Përbërja e ekipit</p> <p>Arkitekt, Planifikues urban / urbanist, Inxhinier</p> <p>CV e stafit kryesor</p> <p>Licenca</p>
Kriteret e pranimit	<p>Studiot e të arkitekturës/urbanistikës të përbërë nga arkitektë, planifikues urbanë, inxhinierë.</p>
Vendimi i jurisë	<p>Kontrolli i dokumentacionit</p> <p>Short – list (x studio për çdo lot)</p>
FAZA 2	<p>SHPLLJA E FITUESVE</p> <p>Shpallja e fituesve për realizimin e Planeve të Detajuara Vendore Faza I dhe Faza II.</p>
FAZA 3	<p>NËNSHKRIMI I KONTRATËS</p> <p>Palët do të nënshkruajnë kontratën për realizimin e PDV Faza I & Faza II, bazuar në këto terma dhe buxhetit të vënë në dispozicion sipas hapave të përcaktuara në shtojcën 3.</p>
FAZA 4	<p>FILLIMI I PROCESIT TË PUNËS</p>
4.1	<p>NDËRRMARJA E NISMËS NGA BASHKIA E TIRANËS PËR HARTIMIN E 23 NJËSIVE SUBJEKT PDV</p> <p>Vënia në dispozicion e dokumentacionit të nevojshëm nga Bashkia e Tiranës për hartimin e PDV:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Informacion për pronat nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) - Informacion mbi rrjetin e infrastrukturës rrugore përcaktuar nga Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV) nga Bashkia e Tiranës
4.2	<p>FILLIMI I PUNËS NGA STUDIO KONSULENTE</p> <p>HARTIMI I PDV FAZA I bazuar në strukturën e përcaktuar në shtojcën 3.</p>
FAZA 5	<p>VLERËSIMI I STUDIMIT DHE HARTIMIT TË PDV NGA KËSHILLI TEKNIK</p>
5.1	<p>VLERËSIMI TEKNIK I PDV FAZA I</p> <p>Grupi i punës (Bashkia Tiranë) i përcjell Këshillit Teknik materilin për vlerësim teknik dhe miratimin e tij.</p>
5.2	<p>AKTI I PËRPUTHSHMËRISË NGA GRUPI I PUNËS</p> <p>Në bazë të Termave të Referencës, kushteve të kontratës dhe pagës së kryer nga Bashkia Tiranë, grupi i punës jep aktin e përputhshmërisë për gjithë procesin e studimit dhe hartimit të PDV Faza I.</p>

5.3 KRYESJA E PAGESËS PËR PDV FAZA I

Pas përfundimit të hartimit të PDV Faza I nga studiot konsulente, do të kryhet pagesa përkatëse nga.....

FAZA 6 VIJIMI I PROCESIT TË PUNËS PËR PDV FAZA 2

Pas miratimit të PDV Faza I për 23 njësitë (3 Lote) dhe përfundimit të hapave të përcaktuar sipas shtojcës 3 , njësitë do i nënshtrohen hartimit të PDV Faza II.

6.1 TAKIME ME GRUPIN E PUNËS

Për bashkërendimin dhe bashkëpunimin e procesit për realizimin e PDV II do të kryhen 5 takime me grupin e punës.

6.2 DORËZIMI I MATERIALIT PDV FAZA II

Studiot konsulente do të dorëzojnë materialin teknik të hartimit të PDV Faza II.

FAZA 7 VLERËSIMI I STUDIMIT DHE HARTIMIT TË PDV FAZA II NGA KËSHILLI TEKNIK

7.1 DORËZIMI I MATERIALIT TË HARTIMIT TË PDV FAZA II NË KËSHILL TEKNIK

Grupi i punës (Bashkia Tiranë) i përcjell Këshillit Teknik materilin për vlerësim teknik.

7.2 AKTI I PËRPUTHSHMËRISË NGA GRUPI I PUNËS

Në bazë të Termave të Referencës, kushteve të kontratës dhe pagës së kryer nga Bashkia Tiranë, grupi i punës jep aktin e përputhshmërisë për gjithë procesin e studimit dhe hartimit të PDV Faza II.

7.3 KRYESJA E PAGESËS PËR PDV FAZA I

Pas përfundimit të hartimit të PDV Faza II nga studiot konsulente, do të kryhet pagesa përkatëse nga.....

KALENDARI I KONKURIST

FAZA 1

THIRRJE E HAPUR PËR PJESMARRJEN NË KONKURS

DT. XX/XX/XXXX

DORËZIMI I DOKUMENTACIONI PËR APLIKIM

DT. XX/XX/XXXX

VENDIMI I JURISË

DT. XX/XX/XXXX

FAZA 2

SHPALLJA E FITUËSVE DT. XX/XX/XXXX

FAZA 3

NËNSHKRIMI I KONTRATËS DT. XX/XX/XXXX

FAZA 4

FILLIMI I PROCESIT TË PUNËS DT. XX/XX/XXXX

Ndërmarrja e nismës nga bashkia e tiranës dhe

Vënia në dispozicion e materialeve bazë për hartimin e pdv.

HARTIMI DHE DORËZIMI I PDV FAZA I DT. XX/XX/XXXX

FAZA 5

VLERËSIMI I STUDIMIT DHE HARTIMIT TË PDV FAZA I NGA KËSHILLI TEKNIK

VLERËSIMI TEKNIK I PDV FAZA I DHE AKTI I PËRPUTHSHMËRISË DT. XX/XX/XXXX

KRYERJA E PAGESËS PËR PDV FAZA I DT. XX/XX/XXXX

FAZA 6

HARTIMI DHE DORËZIMI I PDV FAZA II

Hartimi i PDV Faza II dhe takime me grupin e punës DT. XX/XX/XXXX

FAZA 7

VLERËSIMI I STUDIMIT DHE HARTIMIT TË PDV FAZA II NGA KËSHILLI TEKNIK

VLERËSIMI TEKNIK I PDV FAZA I DHE AKTI I PËRPUTHSHMËRISË DT. XX/XX/XXXX

KRYERJA E PAGESËS PËR PDV FAZA II DT. XX/XX/XXXX

Anekse:

Shtojca 1: Harta e shtrirjes së Pyllit Orbital dhe parqet përbërëse

Shtojca 2: Njësitë subjekt PDV dhe ndarja në lote e Pyllit Orbital

Shtojca 3: Struktura dhe përmbajtja e PDV Faza I & II